

**S T A T U T I dhe AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CODING ” Sh.p.k**

Pjesa e përgjithshme

Ky Statut dhe akt i themelimit dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, rregullojnë marrëdhëniet midis ortakëve të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “CODING ” Sh.p.k.

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “CODING ” Sh.p.k.

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “CODING ” Sh.p.k, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “CODING ” Sh.p.k, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Tiranë, Njesia nr. 3, rruga Nikolla Zoraqi kulla nr. 1, hyrja 1, kati 1 apt nr. 4.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria ka për objekt këto aktivitete:

- aktivitetin e kërkimit dhe zhvillimit, projektimit, prodhimit , shitjes dhe ndihmës me software, hardware, paisje dhe sisteme elektronike dhe elektrike në përgjithësi, telekomunikacion, telefoni, rrjete të shoqërive dhe sisteme të sigurisë informatike.
- aktiviteti i kërkimit dhe zhvillimit, projektimit, prodhimit, shitja ose ndihma me aparatura hardware, software ose makineri dhe/ose elektronike në fushën e robotikës, automatizimit në shtëpi, robotëve industrialë për shumë përdorime (duke përfshirë pjesët)
- shërbime të sistemeve të qendrës së të dhënave dhe servera per ruajtjen e te dhenave (cloud)
- shërbimi transferimit teknologjik, vlerësimi teknik dhe ekonomik, projektimi, studime dhe planifikime në fushën e teknologjive të reja dhe proceseve të reja në fushën e sistemeve teknologjike të avancuara.
- shërbime në marketing, organizime të shoqërisë, menaxhim i burimeve njerëzore, burime të jashtme, qira dhe shpërndarje.
- shërbime të trajnimit dhe formimit të lëndëve informatike dhe elektromekanike

- tregtimi, dhënia me qira, instalimi, mirëmbajtja, riparimi dhe për llogari të të tretëve të softwareve, përpunuesit elektronik, robote, aparatura, materiale, pjesë elektrike dhe elektronike, pjesët aksesore të tyre, makineri të ndryshme
- projektimi, prodhimi dhe shitja e moduleve elektronike dhe të letrës
- shërbime të eliminimit të përdorimit të letrës dhe arkivimi dixhital.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “CODING ” Sh.p.k, do të jetë e pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “CODING” Sh.p.k, mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakut

7.1 Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z.Sauro Magnatti, shtetas italian, i datëlindjes 08.05.1957, me vendlindje Metelica (MC), Itali dhe vendbanim me adresë: Via Cima 58 62024, Esanatoglia (Macerata), Itali, identifikuar me pasaportën nr.YC3331327, lëshuar më datë 13.09.2023, me vlefshmëri deri më 12.09.20233.

7.2 Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “CODING” Sh.p.k, dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tij.

NENI 8

Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

8.1. Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “CODING” Sh.p.k, është 1(një) Kuotë me vlerë 100 000 (njëqindmije) lekë, i gjithi i nënshkruar dhe i shlyer tërësisht nga ortakut i shoqërisë.

NENI 9

Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 10

Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

NENI 11

Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

11.1 Kuotat e kapitalit mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve që nuk bëjnë pjesë në shoqëri pas asnjë kusht apo kufizim.

NENI 12

Asambleja e Përgjithshme

12.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme**.

NENI 13

Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

13.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve, për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- largimin ose përjashtimin e ortakut;

NENI 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

14.3 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga ortakut.

14.4 Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Për tërheqjen e dokumentacionit që do të shqyrtohet në mbledhje ortakët mund t'i drejtohen me shkrim administratorit ose mund t'i tërheqin në selinë e shoqërisë.

14.5 Asambleja do të quhet e vlefshme që në mbledhjen e parë..

14.6 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në selinë e shoqërisë, në video-konferencë, ose në një vend tjetër të përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 15

Pjesëmarrja në Vendôme

15.1 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një ortak ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 16

Procesverbali i Mbledhjes

16.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

16.2 Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i mbledhjes cakton një mbajtës procesverbalit, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i mbledhjes dhe mbajtësi i procesverbalit.

16.3 Procesverbalit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 17

Administratori

17.1 **Administratori** është organi ekzekutiv i shoqërisë.

17.2 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

17.3 Administratori vete personalisht ose me ane të perfaqësuesve të emeruar prej tij me prokurë perfaqësimi ka këto të drejta dhe detyra:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me

- rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- mban librin e adresave të ortakëve të shoqërisë;
- përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

18.4 Administrator i shoqërisë është **z. Baci Arjan**.

NENI 18

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

18.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

18.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

18.3 Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

NENI 19

Shpërndarja e Fitimeve

19.1 Ortaku ka të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

19.2. Shoqëria mund të shpërndajë fitime vetëm pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

NENI 20

Riorganizimi i Shoqërisë

20.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkiinit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

20.2 Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 21

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

21.1 Shoqëria shpërndahet në rastet e parashikuara me ligj ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

21.2 Në rast shpërbërjeje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurave të likuidimit.

21.3 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.


NENI 22
Dispozita të Fundit

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky akt hartohet dhe firmoset në 4 (katër) kopje origjinale, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKU

CODING Sh.p.k
Magnatti Sauro



Tiranë më 10/ Dhjetor /2024